



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej 13,800.00€, ndihmë për shtatëdhjetekatër (74) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin maj 2025, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-400/01-0030668/25
Podujevë, datë 03.06.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të oj-q-ve në Komunën e Podujevës për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta, sipas Thirrjes publike, nr. prot 06-400/04-0013773/25, datë 03.03.2025, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATATAT JOQEVERITARE -OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta, sipas Thirrjes publike datë 03.03.2025, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **20,000.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për kushtet dhe mënyrën e realizimit të projekt/programeve sipas nenit 1 dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0032231/25
Podujevë, 11.06.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 datë 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas Rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/03-0032605/25 datë 12.06.2025, të proceduar dhe rekomanduar për aprovim nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr këtë:

V E N D I M **PËR PËRKRAHJE FINANCIARE**

Neni 1

znj.Etnike Shabani, nga Podujeva, për organizimin e manifestimit përkatësisht koncertit festiv për nder të shënimit të 19 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 4,700.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës, e cila ka për obligim që pas përfundimit të manifestimit të cekur, të dorëzojë raport lidhur me shpenzimet financiare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, të cilat obligohen të veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj.Etnike Shabani (njoftohet përmes DKRS-së).


Nr.prot 02-400/01-0032825/25
Podujevë, datë, 13.06.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 datë 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas Rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025 për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-615/03-0032563/25 datë 12.06.2025, të proceduar dhe rekomanduar për aprovim nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, merr këtë:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Arnisa Gubetini, nga Podujeva, për organizimin e manifestimit përkatësisht koncertit festiv për nder të shënimit të 19 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 2,200.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës, e cila ka për obligim që pas përfundimit të manifestimit të cekur, të dorëzojë raport lidhur me shpenzimet financiare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, të cilat obligohen të veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj.Arnisa Gubetini (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/01-0032824/25
Podujevë, datë, 13.06.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z. Veton Aliu, inxhinier në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahës punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____ 

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksioni, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtorja e Inspeksionit
Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ Arkiva

Nr. prot. 02-016/01-0033475/25
Podujevë, datë: 16.06.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z. Ismet Kadriu, udhëheqës i sektorit të urbanizmit në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksioni, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0033474/25
Podujevë, datë: 16-06-2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë :

A U T O R I Z I M


Autorizohet z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në Komunën e Podujevës, të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, derisa znj. Adelinë Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së cekur të kthehet nga pushimi vjetor, apo eventualisht deri në nxjerrjen e një akti tjetër.

Ky Autorizim vlen nga dita e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-016/01-0035291/25
Podujevë, datë: 24.06.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera dhe Rregulloren (QRK) nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe nenet 14 dhe 19 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. PROT. 02-020/04-0001120/25 DATË 08.01.2025

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot. 02-020/04-0001120/25, datë 08.01.2025 për themelimin e Komisionit lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Podujevës, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin datë 21.03.2025, dhe atë:

Në vend të **Alban Shabani**, për shkak të angazhimit sipas autorizimit në punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me pozitën e zyrtarit kryesor financiar në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, anëtar i Komisionit caktohet,

Arben Neziri, zyrtar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë të përshkruar në nenin 1.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet :
Të caktuarit dhe Anëtarëve të Komisionit (Përmes Kryesuesit)
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-020/04-0035806/25
Podujevë, datë: 26.06.2025





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 4.6 të Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenet 16 dhe 17.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 02-020/04-0078337/23, DATË 25 TETOR 2023

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi për ngritjen e komisionit për inventarizimin e pasurisë jo financiare në pronësi të Komunës së Podujevës Nr. 02-020/04-0078337/23, datë 25 tetor 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. Prot. 02-020/04-0084697/23, datë 29.11.2023, dhe atë:

Në vend të **Alban Shabani**, për shkak të angazhimit sipas autorizimit në punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me pozitën e zyrtarit kryesor financiar në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, anëtar i Komisionit caktohet,

Genc Gashi, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Nr. 02-020/04-0078337/23, datë 25 tetor 2023.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet :

Të caktuarit dhe Anëtarëve të Komisionit (Përmes Kryesuesit)

Zyrës së Personelit

QSHQ/Arkivit


Nr. prot. 02-020/04-0085814/25
Podujevë, datë: 26. 06. 2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, në kërkesë të Drejtoreshës së Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR të datës 25.06.2025, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NDARJE TË SUBVENCIONEVE

Neni 1

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas ftesës publike nr.12-320/01-0030745/25, të datës 04.06.2025, për përkrahje në projektin Furnizim me Mekanizëm Bujqësor Lot II, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- Bleona Musolli , zyrtare për bujqësi – DBPZHR,	kryesuese
- Shefrie Gashi zyrtare për prodhimtari bimore - DBPZHR,	anëtare
- Donjeta Fazliu , zyrtare për bujqësi – DBPZHR,	anëtare

Neni 2

Komisioni punët, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

QSHQ/Arkivit

Nr. Prot. 02-020/04-0036153/25
Podujevë, datë, 27.06.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

